



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 203, datë 25.3.2021

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.186, DATË 26.2.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR CAKTIMIN E NJËSIVE
ZBATUESE PËR RINDËRTIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE
DHE NDËRTIMIN E RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS
PUBLIKE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "iii", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 1, e vendimit nr.186, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese për rindërtimin, sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja, të shpallura në bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë e Shijak."

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1573/1
DATE 29-3-2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

